

VENDIM
Nr. 589, datë 5.9.2012

PËR DISIPLINIMIN E PËRDORIMIT TË SHPENZIMEVE BUXHETORE, PËR VITIN 2012

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 16 e 40 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të nenit 10 të ligjit nr. 10 487, datë 5.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas datës 7 shtator 2012, botimi i çdo lloj njoftimi për prokurim të fondeve buxhetore për shpenzime operative të njërive të qeverisjes qendrore, sipas përcaktimeve në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të bëhet me miratimin paraprak të Ministrit të Financave, pas vlerësimit të burimit të financimit.

Nuk kërkohet miratimi paraprak i Ministrit të Financave për botimin e njoftimeve të kontratave të nënshkruara.

Përfshihen nga rregulli i parashikuar në paragrafin e parë të pikës 1 të këtij vendimi, fondet buxhetore, që shkojnë për shërbimin e ushqimit apo medikamenteve në ato njësi të qeverisjes qendrore, në të cilat kryhet ky shërbim dhe prokurimet me vlerë të vogël.

2. Masa e mbulimit të shërbimit të telefonisë celulare të reduktohet 20%, për çdo përfitues sipas përcaktimeve të vendimit nr. 864, datë 23.7.2010 të Këshillit të Ministrave “Për pajisjen me numër telefoni celular të personave juridikë publikë”.

3. Çdo funksion në njësitë e qeverisjes së përgjithshme, i miratuar në organikë dhe i paplotësuar ende, të ngrijë deri në fund të vitit. Përfshihen nga ky kufizim vendet e paplotësuar, për të cilat është realizuar konkursi, si dhe raste tepër specifike, për të cilat merret miratimi i Ministrit të Financave.

4. Kërkesat për iniciimin e akteve të Këshillit të Ministrave për miratimin e punonjësve me kontratë të përkohshme në njësitë e qeverisjes qendrore pezullohen.

5. Fondi i veçantë, i planifikuar në njësitë e qeverisjes së përgjithshme, nuk përdoret për veprimtari social-kulturore dhe shpërblime deri në datën 5 dhjetor 2012.

6. Shpenzimet për udhëtim e dieta jashtë vendit për njësitë e qeverisjes së përgjithshme të reduktohen, nëpërmjet minimizimit të udhëtimeve, përfshijë ato të një rëndësie të veçantë dhe vetëm për një numër të kufizuar punonjësish. Në çdo rast, për kryerjen e këtyre udhëtimeve të merret miratimi i ministrit/titullarit të institucionit qendror. Në rastin e pjesëmarrjes në konferenca apo aktivitete, për të cilat paguhet tarifë pjesëmarrjeje, merret paraprakisht miratimi i Ministrit të Financave.

7. Trajnimet/seminaret/kurset jashtë vendit për nëpunësit e njësive të qeverisjes së përgjithshme, të parashikuara për t’u mbuluar plotësisht apo pjesërisht me fondet buxhetore të miratuara për vitin 2012, të bllokohen.

8. Fondet buxhetore të papërdorura deri në miratimin e këtij vendimi për trajnimet/seminaret/kurset, përfshijë këtu edhe trajnimet e ITAP-it brenda vendit për nëpunësit e njësive të qeverisjes së përgjithshme, të parashikuara për t’u mbuluar plotësisht apo pjesërisht me fondet buxhetore të miratuara për vitin 2012, të reduktohen në masën mbi 50%.

9. Ngarkohen të gjitha institucionet e njësive të qeverisjes qendrore dhe qeverisjes së përgjithshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha